



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.65/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Klubi Publik i Futbollit "KF F..." – Drenas me seli në Drenas me nr. biznesidhe nr. fiskal, kundër debitorit B.I."M.D." me seli në Drenas me nr. fiskal ... të cilin e përfaqëson M.D. pronar, me bazë juridike përmbartimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Glllogoc, PPP.nr.15/20, të datës 03.06.2020, me datë **23.08.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Klubi Publik i Futbollit "KF "F..." - Drenas me seli në Drenas, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Glllogoc, PPP.nr.15/20, të datës 03.06.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.15/20, të datës 03.06.2020, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e B.I."M.D." me seli në Drenas me nr. fiskal ... të cilin e përfaqëson M.D. pronar, dhe ka anuluar urdhrin e përmbartuesit privat Hakif Hasi me seli ne Glllogoc P.nr.6/20 I dt. 17.01.2020 me te cilin është lejuar propozimi i kreditorit Klubi Publik i Futbollit "KF F... -Drenas me seli ne Drenas me nr. biznesidhe nr. fiskal,per përmbartimin e borxhit ne shumen prej 1.260,00 euro, nga debitori B.I."M.D." me seli ne Drenas me nr. fiskal ... te cilin e përfaqëson M.D. pronar. Në pikën II të këtij vendimi ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra përmbartimore. Ndërsa në pikën III ka vendosur që secila palë të i bart shpenzimet e veta të procedurës përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aktvendimit mbi anulimin e urdhrit përmbartimor, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta anuloi aktvendimin e atakuar si të pabazuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitor.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Klubi Publik i Futbollit "KF F... –Drenas" me seli në Drenas, me datë 17.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit B.I."M.D." me seli në Drenas, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.019/2019 e me datës 01.11.2019, për pagesën në emër të kthimit të mjeteve të paguara dy herë nga ana e kreditorit sipas faturës nr.0000651, për furnizimin me bateri dhe tima nga ana e debitorit, në shumë prej 1,260.00 euro.

Përmbartuesi privat Hakif L. Hasi, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.6/20 të datës 17.01.2020, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 23.01.2020, ka ushtruar prapësim duke theksuar se fatura nëpërmjet të cilës është iniciuar procedura nuk i përmban cilësitë e dokumentit të besueshëm konform neneve të LPP-së, ngase fatura është faturuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori andaj i propozon gjykatës së shkallës së parë të anuloi urdhrin për përmbartim si të pabazuar.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se prapësimi i ushtruar është në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-së, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.15/20, të datës 03.06.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.6/20 të dt.17.01.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin të përmbartuesit P.nr.6/20 i dt.17.01.2020 me të cilin ka lejuar propozimi për mbarim i kreditorit është i bazuar për faktin se nga transaksioni bankar-historiati i llogarisë Bankës E..... i dt.22.01.2020 për periudhën kohore nga dt.01.01.2019 deri me dt.31.12.2019 në emër të debitorit M.D. B.I., vërtetohet se kreditori nga llogaria e tij ka paguar shumën prej 1,260 euro me dt.28.5.2019 në llogarinë e debitorit M.D. B.I. dhe debitori i ka tërhequr nga llogaria e tij shumën prej 1,250 euro me të njëjtën dt.28.5.2019. Gjykata e shkallës së parë i ka shqyrtuar edhe pretendimet e kreditorit për se i ka paguar debitorit sipas faturës nr.0000651 të dt. maj 2019 për furnizim me bateri dhe tima dy herë nga 1.260 euro dhe atë me dt.27 dhe 28.5.2019 por nuk e

pranoi nga se ishte i pa argumentuar me provë nuk i ka bashkangjitur provë flet pagese apo raport të bankës për të argumentuar pretendimin se i ka paguar debitorit dy herë faturën e njëjtë.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me urdhrin përmbarrimor i cili është lëshuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm-faturës, në kundërshtim me nenin 29 të LPP-së, pasi që fatura e cila e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të një anshme nga kreditori, e pa mbështetur në ndonjë punë të vlefshme juridike, ku edhe nga vet pohimi i debitorit rezulton se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka ekzistuar raporti kontraktual, mirëpo debitori pretendimin se ka paguar me tepër se sa ka pas detyrim, ka pasur për qellim ta kthej-realizoj përmes lëshimit të faturës andaj është e papranueshëm për dhomën e shkallës së dytë, lëshimi i një urdhri të tillë përmbarrimor mbi bazën e një dokumenti të papërshtatshëm për përmbarrim si në rastin konkret faturës pa ekzistimin të punës juridike. Gjykata konstaton se kreditori pretendimet e tij ndaj debitorit mund t'i realizoj në procedurë kontestimore duke argumentuar se këtu debitori është pasuruar pa bazë juridike.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.65/2022, me datë 23.08.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v.